



Sindikata e Pavarur e Hekurudhave – Trainkos Sh.A.

Njoftim për media

Data: 15.05.2018

Sindikata e Pavarur e Hekurudhave – Trainkos Sh.A. në mbledhjen e mbajtur me datën **15.05.2018 (e Martë)**, me punëtorët e kompanisë Hekurudhat e Kosovës – Trainkos Sh.A. në lidhje me vonesën e pagave për muajin **Prill 2018**, përmes kësaj shkrese njofton të gjitha mediat se Menaxhmenti të kompanisë HK – Trainkos Sh.A. i ka dhënë kohë që deri të enjten me datën **17.05.2018** të bëjë pagesën e pagave për punëtorë për muajin **Prill 2018**.

Duhet theksuar se me datën **18.05.2018 (e Premte)**, nga ora **08:00** deri në ora **09:00**, në stacionin hekurudhor të Fushë Kosovës, do të mbahet një protestë **1 orëshe** ku do të ndalet edhe qarkullimi i trenit **Prishtinë – Pejë**, në shenjë pakënaqësie për vonesën e pagave. Kjo është vetëm një masë paralajmëruese për veprimet e tjera sindikale të cilat do të pasojnë pas datës 18.05.2018.

Ne si Sindikatë, nuk kemi asnjë njoftim zyrtar (në formë të shkruar) nga Menaxhmenti i kompanisë në lidhje me arsyen e vonesës së pagave për muajin Prill 2018, ndonëse kemi kërkuar që të marrim një njoftim zyrtar nga ana e tyre.

Sindikata ka pasur mirëkuptim për vonesë të pagave deri me datën 14.05.2018, ndonëse në kontratë kompania është e obliguar që pagesën e pagave ta bëjë deri me datën 05 të muajit vijues.

Sindikata e Pavarur e Hekurudhave – Trainkos Sh.A. kërkon nga udhëtarët që të kenë mirëkuptim për ditën e Premte me datë 18.05.2018, ku treni i mëngjesit në linjën Prishtinë – Pejë, do të ketë vonesë 1 orëshe.

Me respekt,

Kryesia e SPH – Trainkos Sh.A.

